

Vendim nr. 72 datë 11.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 11.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ARJAN DHRAMI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 383, datë 10.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. 20-2022-321/28, datë 17.05.2022 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2022-1474, datë 17.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 2, 31, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 49, 50, pika 4, 51/a, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ndaj kërkuarit është regjistruar procedimi penal nr. 164, datë 05.03.2020, me akuzën e kryerjes së veprës penale “Fyerja e gjyqtarit”, të parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal (KP),

si pasojë e kallëzimit të bërë nga shtetasi A.Sh., me profesion avokat. Ky i fundit ka pretenduar se kërkuesi e ka fyer gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Më pas, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka dërguar për gjykim këtë procedim penal në ngarkim të kërkuesit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 383, datë 10.03.2022, ka vendosur: *“Deklarimin e pavlefshëm të aktit procedural “Kërkesë për dërgim në gjyq të çështjes”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për procedimin penal nr. 164 të vitit 2020, me të pandehur Arjan Dhrami, pasi është nxjerrë në kundërshtim me nenet 327/2, 327/4 dhe 331/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.”*. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pushimin e çështjes.

3. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 20-2022-321/28, datë 17.05.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. 383, datë 10.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1474, datë 17.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, për shkak se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 20.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve sipas objektit të kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën e mbrojtjes*, pasi nuk ka qenë në dijeni të çështjes penale në ngarkim të tij, dhe, në këtë mënyrë, nuk i është dhënë mundësia të realizojë mbrojtjen. Kërkuesi nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Prokuroria nuk ka respektuar detyrimin e saj për afatet ligjore të hetimit të parashikuara në nenin 324 të KPP-së, si edhe ka bërë një cilësim juridik të gabuar, pasi veprimet fyese ose shpifëse të kryera ndërmjet dy avokatëve nuk përbëjnë elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 318 i KP-së.

6.2. *Parimin e paanshmërisë*, pasi gjyqtari S.P. që ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë ka pasur lidhje pune me prokurorët e së njëjtës gjykatë, dhe do

të ishte më e drejtë që mos ta gjykonte këtë çështje. Njëanshmëria e këtij gjyqtari konstatohet dhe nga mënyra e trajtimit të çështjes.

6.3. *Të drejtën e aksesit*, për shkak se Gjykata e Lartë ka arritur në konkluzione jo të drejta. Ajo duhej të pranonte rekursin dhe bazuar në nenin 441, shkronja “dh”, të KPP-së të ndryshonte vendimet e dy gjykatave më të ulëta, duke pushuar çështjen.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

7. Çështja e legjitimit (locus standi) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe,

në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rastin konkret vendimet e kundërshtuara nga kërkuesi janë vendime gjyqësore të cilat kanë disponuar për kthimin e akteve procedurale prokurorisë për ripërsëritjen e tyre. Për shkak të këtyre vendimeve gjyqësore, procedimi penal është kthyer në fazën e hetimeve paraprake. Për rrjedhojë, vendime të këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit ende nuk ka mbaruar, nuk mund të quhen përfundimtare për efektet e gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë gjykimit të themelit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Në këto kushte, Kolegji çmon se Gjykata nuk mund të bëjë gjykimin përfundimtar të ankimit kushtetues kundër vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, pasi nuk janë shteruar ende të gjitha mjetet juridike efektive dhe kërkuesi nuk legjitimohet për t’iu drejtuar asaj.

11. Në kushtet kur nuk plotësohet një nga kriteret kumulative të ankimit kushtetues individual, të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji çmon se nuk është i nevojshëm analizimi i mëtejshëm i kriterëve të tjera.

12. Në përfundim, Kolegji vlerëson se çështja nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtimin e saj në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.